



## **“Sëmundja nuk transmetohet vetvetiu te tjetri. Oguret nuk ndikojnë. Zëri i kukuvajkës nuk ndjell ogur të keq. Muaji i Seferit nuk është muaj ters. E, sa i përket të lebrosurit, ik prej tij siç ikën prej luanit!”**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Sëmundja nuk transmetohet vetvetiu te tjetri. Oguret nuk ndikojnë. Zëri i kukuvajkës nuk ndjell ogur të keq. Muaji i Seferit nuk është muaj ters. E, sa i përket të lebrosurit, ik prej tij siç ikën prej luanit!”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar disa çështje të kohës paraislame (xhahilietit), si paralajmërim ndaj tyre dhe si shpjegim se çështja është në dorë të Allahut dhe se asgjë nuk ndodh pa urdhrin dhe caktimin e Tij. Këto gjëra janë: E para: njerëzit e kohës paraislame besonin se sëmundja ishte ngjitëse vetvetiu, kështu që Profeti ﷺ ndaloi të besohet se sëmundja transmetohet vetvetiu nga i sëmuri te të tjerët, për faktin se Allahu është Ai që e ka në dorë universin dhe është Ai që e lëshon sëmundjen dhe e largon, dhe këto ndodhin vetëm me vullnetin dhe caktimin e Tij. Së dyti: nëse njerëzit e kohës paraislame dilnin për udhëtim ose tregti, i trembnin zogjtë: nëse fluturonin djathtas, e merrnin si shenjë të mirë, e, nëse fluturonin majtas, e quanin si shenjë tersi dhe ktheheshin, kështu që Profeti ﷺ ndaloi që njeriu ta konsiderojë ters veprimin e zogjve dhe sqaroi se ky është besim i kotë. Së treti: njerëzit e kohës paraislame thoshin se, nëse kukuvajka ulet në një shtëpi, familjes së saj do t'i ndodhë ndonjë fatkeqësi, kështu që Profeti ﷺ e ndaloi që njerëzit ta quajnë ters këtë gjë. E katërta: e ndaloi ta quajmë ters muajin e Seferit, i cili është muaji i dytë hënor. Mendohet gjithashtu se seferi është një parazit që ndodhet në stomak, që i prek bagëtitë dhe njerëzit. Ata pretendonin se ky parazit ishte më ngjitës sesa lebra, kështu që e ndaloi këtë bindje. E pesta: Profeti ﷺ urdhëroi të qëndrohet larg personit që ka sëmundje të lebrës, ashtu siç njeriu qëndron larg nga një luan. Kjo është një masë parandalimi dhe sigurie për veten, si dhe zbatim i shkaqeve që ka urdhëruar Allahu për t'i bërë. Lebra është një sëmundje (që shfaqet në lëkurë), nga e cila konsumohen organet e njeriut.

النجاة الخيرية  
ALNAJAT CHARITY

